



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 1, datë 11.05.2020

PËR
MIRATIMIN E PLANIT TË DETYRUAR VENDOR, ZONA 4, SPITALLË, NËSIA
ADMINISTRATIVE DURRËS, BASHKIA DURRËS


Në mbështetje të neneve 3, 7, 18 dhe 25 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, të Aktit Normativ Nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, të VKM Nr. 887, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurës së përshpejtuar për hartimin dhe miratimin e planit të detyruar vendor, si dhe procedurës së miratimit të lejeve të zhvillimit/ndërtimit, në rastet e fatkeqësisë natyrore”, të VKM Nr. 9, datë 10.1.2020 “Për caktimin e njësive zbatuese për hatimin e planeve të detyruara vendore dhe financimin e tyre nga fondi për rindërtimin, miratuar në buxhetin e vitit 2020”, të VKM Nr. 164, datë 19.2.2020 “Për shpalljen e zonës së re për zhvillim, në Njësinë Administrative Durrës, bashkia Durrës, dhe caktimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit si njësi zbatuese”, të Vendimit Nr. 686, datë 22.11.2017 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, i ndryshuar si dhe të Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit” i ndryshuar, me propozimin e Bashkisë Durrës dhe Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Planit të Detyruar Vendor për zonën 4, Spitallë, e shpallur si zonë e përshtatshme për zhvillim në Njësinë Administrative Durrës, Bashkia Durrës, pjesë e të cilit janë dokumentet e mëposhtëm:
 - a) Raporti i Planit të Detyruar Vendor;
 - b) Plani i Përdorimit të Tokës;
 - c) Planimetria e Projektimit Urban;
 - d) Plani i Infrastrukturave;
 - e) Skema e Apartamenteve dhe Udhëzuesi Arkitektonik.
2. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit për botimin e Planit të Detyruar Vendor për zonën 4, Spitallë, Durrës në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit brenda 15 ditëve nga miratimi i tij.

3. Ngarkohet Bashkia Durrës për zbatimin e Planit të Detyruar Vendor, si dhe për bashkërendimin e punës në zbatim të këtij plani me AKPT-në, Ministrinë përgjegjëse për Rindërtimin, sipas fushave të përgjegjësisë.

4. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

